

Z. Mark NDRECA

punon në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar /DSIK/ që nga viti 2002. Fillimisht, për periudhën 2002 – 2003, ka punuar jurist. Me pas, deri në vitin 2008 ka qenë Shef i Sektorit të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Regjistrit Qendror të NATO-s. Nga viti 2008 deri në shkurt të vitit 2014 ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Vetting-ut dhe të Regjistrit Qendror të NATO-s. Pas kësaj periudhe e në vazhdim është Drejtor i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial.

Në pozicionin aktual, drejton dhe menaxhon punën e Sektorit të Vetting-ut dhe të Sektorit të Sigurimit Industrial. Është përgjegjës dhe mbikëqyr përmbushjen e standardeve për aspektet procedurave të sigurimit të personelit dhe të sigurimit të informacionit të klasifikuar në fushën industriale. Gjatë punës së tij, ai bashkëpunon me stafin që drejton, Shërbimet e Inteligjencës, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe strukturat homologe.

Ka përfunduar studimet e larta në Akademinë e Sigurisë (ish-shkolla e lartë e MPB) dhe në Fakultetin e Drejtësisë. Është specializuar në Akademinë Diplomatike Shqiptare, në Kolegjin e Lartë të Mbrojtjes dhe ka bërë një Post-Mastër në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Është trajnuar për çështjet e sigurisë, inteligjencës dhe të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar.

Mban gradën shkencore “Doktor”.